



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 21.7.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË MINISTRISË SË PUNËS  
DHE MIRËQENIËS SOCIALE  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Igballe Halili Udhëheqëse e ekipit, Veton Misiri, Krenare Pirana dhe Vjosë Bojku anëtare, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	25
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	26
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....	28
Shtojca IV: Letërkonfirmimi .....	34

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Auditimit, të datës 15/11/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale. Për më gjerësisht shih pjesën 1.2 të këtij raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Ministrinë dhe stafin e tij për bashkëpunimin e ofruar gjatë procesit të auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**

Procesi i përgatitjes së PFV-ve është menaxhuar mirë, me përjashtim të shpalosjeve të cilat kanë rezultuar me disa gabime.



Ministri duhet të sigurojë që procesi i përgatitjes së PFV 2017 përfshinë një rishikim menaxherial formal dhe efektiv dhe deklarata për PFV-të të nënshkruhet vetëm pasi janë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih nënkapitullin 1.3).

Procesi i vetvlerësimit dhe përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Ministri duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet 2 dhe 3).

Aranzhimet e qeverisjes dhe llogaridhënies në menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial kanë shënuar progres të dukshëm, por ka hapsirë për përmirësim të vazhdueshëm.



Ministri duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë vazhdueshme për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për të nritur efektivitetin operativ (shih çështjet 4 - 5).

Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive - ekzistojnë ende dobësi në disa sisteme të rëndësishme financiare duke përfshirë, subvencionet dhe transferet, prokurimin dhe pagat e mëditjet.



Ministri duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave brengosëse të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 11 deri 18).

**Përgjigja e Ministrit - auditimi 2016**

Ministri i ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet si dhe është zotuar se do t'i implementojë rekomandimet e dhëna.

---

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacioneve të prezantuara në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacioneve në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

### Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i MPMS-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të

---

mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

---

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MPMS kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Kërkesa tjera (kërkesat buxhetore; raportet tremujore duke i përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore dhe planin e prokurimit).

Në kontekst të PFV-ve, edhe pse Ministria kishte bërë korrigjimet e draft PFV-ve sa i përket dy tabelave kryesore, informatat e shpalosura rreth pasurive dhe detyrimeve nuk ishin të sakta. Prandaj, përveç çështjeve të shpalosura tek theksimi i çështjes, ne kemi identifikuar edhe gabimet në vijim:

- Ministria nuk kishte bërë regjistrimin e gjithë pasurisë së saj, ngase investimet në vijim në vlerë 143,113€ nuk ishin regjistruar në SIMFK;
- Pasuritë jo kapitale (nën 1,000€) ishin nënvlerësuar për 4,610€;
- Obligimet e papaguara ishin nënvlerësuar për të paktën 50,740€, pasi që faturat e pranuar në janar 2017 që i takonin vitit 2016, nuk ishin shpalosur;
- Detyrimet kontingjente të shpalosura nuk përmbanin vlera monetare, por janë shpalosur vetëm si raste në kontest gjyqësor; dhe
- Për shkak të mungesës së buxhetit, MPMS kishte mbetur pa i kryer obligimet ndaj veteranëve të luftës së UÇK-së në vlerë prej mbi 4.2 milion euro, dhe në PFV nuk janë shpalosur informata në lidhje me këto obligime. Përkundër faktit se me rregulloret financiare aktuale nuk kërkohet që këto lloj obligime të shpalosen, për shkak të vlerës së lartë dhe implikimit buxhetor në vitin pasues, ministria është dashur që ketë çështje ta shpalosë në PFV.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, ndonëse ekzistojnë gabime që nuk kanë ndikuar në modifikimin e opinionit të auditimit.



Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur. MPMS ka arritur të dorëzojë me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore.

### 1.3 Rekomandimi për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipër përmendura ne rekomandojmë që:

**Rekomandimi 1** Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në gabimet e prezantuara në PFV. Duhet të ndërmerren veprime konkrete për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për ta siguruar inventarizimin e rregullt të të gjitha pasurive dhe shpalosjen e saktë të vlerës së pasurive dhe detyrimeve në PFV.

## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MPMS-në që të menaxhojë me sukses sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga MPMS të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente për të përcaktuar cilësinë e të plotësuar për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

## Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Përkundër progresit të arritur, edhe me tutje ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MPMS-së veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga MPMS-së, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi aranzhimet ekzistuese që nuk bazohen mjaftueshëm në dëshmi.

Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme, mirëpo Komiteti i Auditimit nuk ka kontribuar mjaftueshëm në zbatimin e rekomandimeve. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit të jashtëm duhet të zhvillohen tutje.

### 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e MPMS-së të vitit 2015 të ka rezultuar në 20 rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Për më tepër, menaxhmenti i Ministrisë ishte angazhuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna në vitin e kaluar, duke përgatitur edhe raporte mujore mbi veprimet e ndërmarra. Megjithatë, edhe më tutje mbetet sfidë zbatimi i plotë i të gjitha rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, katër (4) rekomandime ishin zbatuar; 12 ishin në proces të zbatimit dhe katër (4) të tjera nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

#### Çështja 2 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

**E gjetura** Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar është zbatuar edhe pse MPMS ka ndjekur një proces formal mujor për të monitoruar mënyrën e zbatimit të tyre.

**Rreziku** Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të vitit paraprak mund të rezultojë në vazhdimin e dobësive në kontrollet e brendshme duke rezultuar në:

- Planifikim të dobët të buxhetit në fushën e subvencioneve dhe investimeve kapitale; dhe
- Mangësi në menaxhimin e pasurive, personelit dhe prokurimit.

**Rekomandimi 2** Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

## 2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MPMS-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

### Çështja 3 – Pyetësi i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë

**E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Vlerësimi i disa pyetjeve nuk përkon me gjendjen reale, po ashtu disa përgjigje nuk ishin të mbështetura me dëshmi;
2. Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga MPMS ka vërtetuar se ka procedura formale të dokumentuara, të vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut. Megjithatë, deri në fund të auditimit nuk është vërejtur se është bërë vlerësimi dhe monitorimi i aktiviteteve ndërlidhur me menaxhimin e rreziqeve;
3. Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit konsiderohet se është e vendosur pjesërisht nga ana e MPMS-së, për arsye se strategjia ishte Draft Strategji e cila nuk është e miratuar nga Qeveria dhe si e tillë nuk ka mundur të gjej zbatim nga e ana e Ministrisë; dhe
4. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura dhe të mbështetura nga Ministria.

Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lartë. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vet-vlerësimi i vitit 2015 ishte i limituar.

**Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

**Rekomandimi 3** Ministri duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

---

## 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MPMS operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

MPMS ka nën menaxhimin e saj shtatë (7) qendra rajonale të Departamentit të Administratës Pensionale, shtatë (7) qendra rajonale të punësimit dhe tetë (8) qendra për aftësim profesional. Raportimi financiar dhe operativ bëhet përmes departamenteve përkatëse. Për të siguruar një menaxhim financiar efektiv nevojitet një proces efektiv i konsolidimit dhe raportim me kohë.

Menaxhmenti duhet të zbatojë një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

---

#### Çështja 4 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë

- |                      |   |
|----------------------|---|
| <b>E gjetura</b>     | Edhe përkundër faktit se departamentet bëjnë raportime të rregullta, jo të gjitha raportet përmbajnë informata të plota, lidhur me të gjitha aktivitetet brenda organizatës. Poashtu takimet e mbajtura nga Sekretari i Përgjithshëm me drejtorët e departamenteve, jo gjithëherë mbuloreshin me procesverbale. |
| <b>Rreziku</b>       | Cilësia e dobët e raportimit tek menaxhmenti i lartë, e redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve të brendshme.   |
| <b>Rekomandimi 4</b> | Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim specifik për të përcaktuar një formë më të përshtatshme të raportimit tek menaxhmenti i lartë, për të rritur efikasitetin e raporteve dhe kontrolleve.   |

---

## 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre (3) anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe dy (2) auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet e MPMS-së dhe i cili ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

---

### Çështja 5 - Mos funksionimi efektiv i Komitetit të Auditimit - Prioriteti i mesëm

**E gjetura** NjAB kishte përfunduar 20 nga 22 auditimet e planifikuara në planin vjetor të auditimit dhe dy (2) auditime tjera me kërkesë të menaxhmentit. Kjo do të thotë se plani është realizuar pothuajse plotësisht. Në raportet e veta NjAB ka dhënë rekomandime për përmirësimin e mangësive të identifikuara.

Ne kemi vërejtur se ka munguar kontributi i Komitetit të Auditimit (KA) në drejtim të zbatimit të këtyre rekomandimeve. Kjo vërtetohet me faktin se përgjatë vitit 2016 KA kishte mbajtur vetëm dy (2) takime.

**Rreziku** Mos mbajtja me rregull e takimeve të KA-së zbehtë rëndësinë e raporteve të NjAB-së, pasi që humbet mundësia e përfitimit nga diskutimet dhe këshillat profesionale të KA mbi punën dhe rezultatet e NJAB, si dhe kontributi i tyre në zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së.

**Rekomandimi 5** Ministri duhet të siguroj funksionimin efektiv të KA, për të përkrahur NjAB-në në realizimin e objektivave, dhe për ta ndihmuar menaxhmentin në zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MPMS në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtijshëm për të parandaluar MPMS-në që mos të pësojë humbje financiare, vlerë të dobët për parandë dhe menaxhim jo efektiv. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë menaxhimi i skemave pensionale me theks të veçantë tek veteranët e luftës, menaxhimi i pasurisë, dhe respektimi i rregulloreve në fushën e burimeve njerëzore dhe prokurimit.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Të hyrat e mbledhura për buxhetin e Kosovës (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat jotatimore	-	-	247,958	200,126	324,526

Të hyrat e realizuara nga MPMS në 2016 ishin në vlerë 247,958€. Ato derdhen në buxhetin e Kosovës dhe nuk shfrytëzohen nga Ministria. Për shkak se të hyrat realizohen kryesisht nga gjobat e inspektoratit, nuk bëhet ndonjë planifikim se sa të hyra pritet të realizohen.

**Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>359,522,381</b>	<b>376,782,972</b>	<b>376,550,042</b>	<b>315,278,581</b>	<b>283,792,987</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	359,522,381	376,579,957	376,407,020	315,275,283	283,697,987
Donacionet e jashtme	-	203,015	143,022	3,298	95,000

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 17,260,590€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së aplikuar pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë 17,057,575€ dhe donacioneve të jashtme 203,015€.

Në vitin 2016, MPMS ka përdorur afro 100% të buxhetit final ose 376,550,043€, ngjashëm me vitin 2015. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>359,522,381</b>	<b>376,782,972</b>	<b>376,550,042</b>	<b>315,278,581</b>	<b>283,792,987</b>
Pagat dhe Mëditjet	4,951,084	4,872,819	4,848,167	5,104,701	4,748,298
Mallrat dhe Shërbimet	1,872,538	3,063,856	3,058,654	2,304,590	2,460,819
Shërbimet komunale	357,085	367,851	342,875	379,254	381,976
Subvencionet dhe Transferet	351,311,674	367,843,849	367,754,672	305,718,653	274,727,733
Investimet Kapitale	1,030,000	634,597	545,674	1,771,383	1,474,160

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte më i vogël për 78,265€ në krahasim me atë fillestar. Kjo ishte rezultat i zvogëlimit me rishikim të buxhetit në vlerë 79,000€, dhe në emër të kursimeve buxhetore 735€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%;
- Buxheti final i mallrave dhe shërbimeve ishte më i lartë se ai fillestar për 1,191,319€. Këtu përfshihet transferi prej kategorisë së subvencioneve për provizionet bankare me vlerë 1,400,000€, dhe përfshirjes së donacioneve të jashtme me vlerë 63,750€. Në anën tjetër kishte zvogëlim të buxhetit me rastin e rishikimit të buxhetit për 147,954€ dhe kursime buxhetore 124,478€;

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

- Buxheti për shërbime komunale ishte rritur për 10,766€. Fillimisht kishte rritje me rishikim të buxhetit për 14,000€, derisa në fund vit kishte një zvogëlim në emër të kursimeve buxhetore për 3,234€;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte më i lartë për 16,532,175€, krahasuar me atë fillestar. Rritja kishte ardhur si rezultat i rishikimit të buxhetit për 6,950,000€, dhe me vendim të Qeverisë për 11,835,000€ si dhe donacioneve të jashtme 24,000€. Përveç kësaj kishte edhe lëvizje tjera buxhetore në këtë kategori, përfshirë transferin e 1,400,000€ në mallra dhe shërbime (për provizionet bankare) dhe kursime buxhetore prej 876,825€; dhe
- Buxheti final i investimeve kapitale ishte më i ultë për 395,403€ në krahasim me atë fillestar. Fillimisht kishte zvogëlim me rishikim me vlerë 260,509€. Pastaj me vendim të Qeverisë kishte shkurtime në këtë kategori në vlerë 250,159€. Ndërsa nga donacionet e jashtme kishte një rritje për 115,264€ (Qeveria Zvicerane 70,000€ dhe GIZ 45,264€).

## Çështja 6 – Planifikimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Pavarësisht ekzekutimit të buxhetit në nivelin 100%, planifikimi i buxhetit ka hapësirë për përmirësim, sidomos tek subvencionet dhe transferet dhe investimet kapitale. Kjo për shkak se tek subvencionet dhe transferet është dashur të shtohen shuma të konsiderueshme mjetesh në buxhet, dhe te investimet kapitale ishte shfaqur nevoja për përshtatje të shumta përgjatë vitit. Për të përmirësuar planifikimin e buxhetit, kërkohet përveç tjerash që MF të bëjë vlerësim më të detajuar të kërkesave buxhetore të paraqitura nga MPMS-ja.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit mund ta vë Ministrinë në vështirësi buxhetore si pasojë e mungesës së kapaciteteve financiare për t'i kryer obligimet ligjore për skemat pensionale dhe ato sociale. Kjo po ashtu mund të shpijë deri tek paditë e ndryshme ndaj ministrisë si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve duke rezultuar me detyrime kontingjente të cilat ndikojnë në buxhetin e viteve pasuese.
- Rekomandimi 6** Ministri duhet të sigurojë që të thellohet dialogu me MF-në rreth planifikimit të buxhetit me theks të veçantë tek skemat sociale dhe pensionale në mënyrë që të evitohen vështirësitë e vazhdueshme në realizimin e obligimeve ligjore dhe të synimeve paraprakisht të caktuara.

### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MPMS në 2016 ishin në vlerë 247,958€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga Autoriteti i Inspektoriatit të Punës (AIP) dhe Departamenti për Punë dhe Punësim (DPP). Të hyrat e inkasuara derdhen në buxhetin e Kosovës dhe nuk shfrytëzohen nga Ministria.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollat që operojnë në nivel të Ministrisë kanë të bëjnë me: menaxhimin e personelit, autorizimin e listës së pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme; rishikimin e buxhetit për këtë kategori barazimet me Thesarin etj. Testet tona shpalosen mangësitë si në vijim.

#### Çështja 7 - Ushtrues detyre më gjatë se tre muaj - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas Ligjit për Shërbimin Civil, Ushtruesi i Detyrës (UD) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj. Ne, kemi vërejtur se në katër (4) raste ishte tejkaluar koha e ushtrimit të pozitive me UD. Për plotësimin e dy (2) prej tyre, ishin shpallur konkurset, mirëpo kishin dështuar në mungesë të kandidatëve të përshtatshëm, ndërsa, për plotësimin e dy (2) pozitive tjera, nuk ishin iniciuar procedurat.
- Rreziku** Mbulimi i pozitive me UD më gjatë se afati i paraparë ligjor, përveç që është në kundërshtim me normat ligjore, mund të rezultojë në performancë të dobët operacionale dhe rrjedhimisht me mosarritje të objektivave të Ministrisë.
- Rekomandimi 7** Ministri duhet të sigurojë se janë respektuar afatet ligjore në rastet e ushtrimit të pozitive të caktuara dhe që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për plotësimin me kohë të pozitive me staf të rregullt.

#### Çështja 8 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta - Prioritet i mesëm

- E gjetura** MPMS kishte 22 persona të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta. Ne kemi testuar katër (4) kontrata dhe kemi vërejtur se në dy (2) raste kontratat ishin vazhduar çdo gjashtë (6) muaj. Kjo është në kundërshtim me rregullat e aplikueshme. Pagesa e tyre ishte bërë nga mallrat dhe shërbimet dhe arsyeja e angazhimit ishte mungesa e buxhetit për paga dhe mëditje.
- Vlen të theksohet se MPMS kishte pozita të aprovuara të punëtorëve të mjaftueshme mirëpo nuk kishte buxhet të mjaftueshëm për mbulimin e pagave të tyre.
- Rreziku** Angazhimi i punëtorëve me marrëveshje për shërbime të veçanta, më gjatë se koha e përcaktuar mund të rezultojë në mos efikasitet operacional dhe mosarritje të objektivave të organizatës. Ndërsa, numri i lartë i tyre mund të shkaktoj kosto shtesë për shërbimet e ofruara.
- Rekomandimi 8** Ministri duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta do të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se gjashtë (6) muaj.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 3,431,708€ (përfshirë shërbimet komunale). Prej tyre ishin shpenzuar 3,401,529€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material harxhues, shërbime, mirëmbajtje dhe shërbime komunale.

#### Çështja 9 - Mangësi gjatë procedurave të prokurimit - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Te aktiviteti i prokurimit për "Furnizim me Material Trajnimi për Qendrat e Aftësimit Profesional (QAP)"- gjashtë (6) lloje, disponueshmëria e mjeteve ishte nënshkruar pas zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Te i njëjti aktivitet, njësitë kërkuese për secilin lloj kishin bërë kërkesa të veçanta për materiale të ndryshme, dhe rroba pune si dhe këpucë për kursantët e Qendrave të Aftësimit Profesional (të profesioneve: kuzhinier, frizer, rrobaqepës, saldues, zdrukthëtar dhe ndërtimtar). Megjithatë gjatë hartimit të specifikave teknike në dosjen e tenderit, artikujt që kanë të bëjnë me furnizimin me rroba pune dhe këpucë pune janë përshkruar vetëm tek lloji VI "Furnizim me Material Trajnimi për Rrobaqepësi, Rroba Pune dhe Këpucë Pune", duke përfshirë rroba pune dhe këpucë pune të njëjta, për të gjitha profesionet.

**Rreziku** Përgatitja e dosjes së tenderit para nënshkrimit të disponueshmërisë së mjeteve, rrezikon realizimin e procedurave të tenderit për mungesë eventuale të fondeve. Mungesa e qartësisë gjatë hartimit të specifikave teknike, mund të shpie në kontraktimin e pajisjeve/rrobave dhe këpucëve jo adekuate për profesionet e lartpërmendura.

**Rekomandimi 9** Ministri duhet të sigurojë se para secilit aktivitet të prokurimit fillimisht të konfirmohet disponueshmëria e mjeteve. Përveç kësaj specifikat teknike duhet të jenë të qarta për të mundësuar kontraktimin dhe furnizimin me artikuj adekuat sipas kërkesave të njëjste kërkuese.

### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Mbi 97% e shpenzimeve të përgjithshme të MPMS-së i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve. Këto kanë të bëjnë me skemat pensionale dhe sociale, pensionet e parakohshme, subvencionet për përfitues individual dhe publik, etj. Falë bashkëpunimit me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC), Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe me Bashkësinë Islame, gjatë vitit 2016 Ministria kishte arritur që t'i reduktojë në masë të madhe pagesat për pensionistët pas vdekjes dhe disa nga pagesat e parregullta të cilat ishin identifikuar nga auditimet e viteve paraprake, tek disa skema pensionale dhe sociale. Megjithatë mbetet sfida edhe më tej menaxhimi i skemave, me theks të veçantë tek veteranët dhe ndihmat sociale.

**Çështja 10 - Pagesa e pensioneve për personat e vdekur - Prioritet i lartë****E gjetura**

Sipas Ligjeve përkatëse të skemave pensionale dhe rregullave të aplikueshme, pensionet duhet të ndalen pas vdekjes së përfituesve. Nga krahasimi i të dhënëve ndërmjet MPMS dhe ARC-së, kemi konstatuar se gjatë vitit 2016, pensionet e paguara pas vdekjes së përfituesve, arrin vlerën 115,006€. Vlen të theksohet se kishte raste kur pensionet ishin paguar deri në 12 muaj pas vdekjes së përfituesve.

Megjithatë, ekziston një përmirësim i dukshëm në menaxhimin e skemave pensionale në raport me vitin e kaluar (në vitin 2015, pagesat për pensionet e paguara pas vdekjes ishin 801,723).

**Tabela 4. Pensionet e paguara pas vdekjes së përfituesve**

Lloji i pensionit (skemës pensionale)	Pagesat për përfituesit që kanë vdekur para 2016		Pagesat për përfituesit që kanë vdekur gjatë 2016		Total gabimi financiar 2016	
	Numri i pagesave	Shuma (€)	Numri i pagesave	Shuma (€)	Numri i pagesave	Shuma (€)
	<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d</i>	<i>(a + c)</i>	<i>(b + d)</i>
Pensionet Trepça	2	840	5	525	7	1,365
Pensionet e Asistencës Sociale	10	836	-	-	10	836
Pensionet Bazë (PB)	164	12,800	359	28,200	523	41,000
Pensionet Kontributive (PK)	91	15,132	133	22,864	224	37,996
Pensionet për personat me aftësi të Kufizuara (PPAK)	263	20,205	78	6,675	341	26,880
Veteran	15	2,271	28	4,658	43	6,929
<b>Gjithsej</b>	<b>545</b>	<b>52,084</b>	<b>603</b>	<b>62,922</b>	<b>1,148</b>	<b>115,006</b>

**Rreziku**

Mbetja e personave të vdekur në listat e pagesave të pensioneve, rezulton me pagesa të parregullta dhe me dëmtim të buxhetit.

**Rekomandimi 10**

Ministri duhet të sigurojë se janë përforcuar edhe më tutje kontrollet e brendshme, për të siguruar pastrimin e listave, duke bërë krahasimin sistematik të regjistrave me regjistrin civil, në baza mujore, para se të bëhet kompensimi i pensioneve. Poashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për kthimin e pensioneve të dhëna pa bazë.

**Çështja 11 - Përfitime të pensioneve nga persona të punësuar - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Nga krahasimi i regjistrave ndërmjet MPMS-së dhe ATK-së, kemi konstatuar se ekzistojnë raste të përfitimit të pensioneve nga persona të cilët punojnë apo që realizojnë të ardhura pensionale. Në raport me vitin paraprak ka përmirësime, kryesisht te skema e pensioneve të Trepçës dhe ndihmat sociale. Derisa nevojitet shtim i kontrolleve për të evituar pagesat ndaj personave që nuk ju takojnë me ligj, sidomos tek kategoria e veteranëve. Në raport me vitin 2015, vlera e gabimit financiar pothuajse është dyfishuar. Nga 247,210€ sa ishte në vitin 2015, ka arritur në 405,452€ në vitin 2016.

**Tabela 5. Përfitimet e pensioneve nga personat e punësuar**

Lloji i skemës pensionale	Numri i pagesave	Gabimi Financiar
Pensionet e Trepçës	171	18,655
Pensionet e ndihmave sociale	503	50,709
Pensionet për personat me aftësi të kufizuara	1,359	120,600
Veteran	1,275	215,488
<b>Gjithsej</b>	<b>3,308</b>	<b>405,452</b>

**Rreziku** Përfitimi i pensioneve dhe ndihmave sociale nga persona të punësuar është në kundërshtim me ligjin, si dhe shkakton pagesa të parregullta dhe dëmtim të buxhetit.

**Rekomandimi 11** Ministri duhet të sigurojë forcimin e mëtejshëm të kontrolleve të brendshme, me qëllim të pastrimit të listave, në mënyrë që personat e punësuar të mos përfitojnë pensionet që nuk ju takojnë. Duhet të bëhen krahasimet sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK, para ekzekutimit të pagesave. Po ashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme ndaj përfituesve, në mënyrë që mjetet e përfituara pa bazë ligjore të kthehen në buxhetin e ministrisë.

**Çështja 12 - Përfituesit e dyfishtë të skemave pensionale - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Nga krahasimi i shënimeve ndërmjet skemave pensionale brenda ministrisë, kemi konstatuar se kontrollet e brendshme ishin shtuar dukshëm, krahasuar me vitin e kaluar dhe si rrjedhojë kishte reduktim të përfituesve të skemave të dyfishta pensionale (në vitin 2015 vlera e gabimit financiar ishte 401,497€). Megjithatë edhe më tutje kemi gjetur raste ku persona të njëjtë ishin përfitues në më shumë se një skemë pensionale. Kjo është në kundërshtim me rregullativën ligjore në fuqi. Në tabelën në vijim janë paraqitur rastet e identifikuar sipas kategorive pensionale.

Tabela 6. Përfituesit e dyfishtë të skemave pensionale

Lloji i skemës pensionale	Numri i pagesave	Gabimi Financiar
Trepça përfitues në skemën e Kontributive.	2	315
Trepça përfitues në skemën e Ndihmave Sociale	8	724
FSK përfitues në skemën e Ndihmave Sociale	1	74
Pensionet Bazë përfitues në skemën e TMK-së.	275	21,450
Pensionet Bazë përfitues në skemën e PPAK-së.	1	75
Pensionet Kontributive përfitues në skemën e TMK-së.	216	39,782
Veteran përfitues edhe në skemën e pensioneve bazë	42	3,375
Veteran përfitues edhe në skemën e pensioneve kontributive	33	5,508
Veteran përfitues në skemën e PPAK-së	28	2,850
Veteran përfitues në skemën e TMK-së	8	1,360
Veteran përfitues në skemën e Trepçës	1	105
Veteran përfitues në skemën e Ndihmave Sociale	834	84,130
Ndihmat Sociale përfitues në skemën e pensioneve	3	225
<b>Gjithsej</b>	<b>1,452</b>	<b>159,973</b>

**Rreziku** Pagesat e pensioneve të dyfishta për personat e njëjtë, janë në kundërshtim me ligjin, dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit.

**Rekomandimi 12** Ministri duhet të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të kontrolleve të brendshme për të krijuar një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale. Të analizohen mundësitë për krijim të një softueri të integruar të të gjitha skemave pensionale, në mënyrë që të eliminohet mundësia e përfitimeve të dyfishta të pensioneve. Poashtu duhet të merren të masat ligjore në mënyrë që përfituesit t'i kthejnë mjetet e përfituara jashtëligjshëm në buxhetin e ministrisë.

### Çështja 13 - Aprovim i subvencioneve pa plotësim të kriterëve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** MPMS kishte përkrahur financiarisht tri (3) OJQ<sup>2</sup> me gjithsej 36,256€. Ne kemi vërejtur se këto OJQ nuk e kishin plotësuar kriterin e raportimit mbi gjendjen financiare për dy (2) vitet e kaluara, ndërsa njëra nga to nuk kishte dorëzuar CV-të e ekspertëve të angazhuar në projekt. Përkundër kësaj, komisioni vlerësues kishte rekomanduar që projektet e këtyre OJQ-ve të subvencionohen. Kjo është në kundërshtim me dispozitat e rregullores së Ministrisë nr.02/2015 për kriteret dhe procedurat e përkrahjes financiare për subvencione dhe grante.
- Rreziku** Mos respektimi i kriterëve të përcaktuar për përkrahjen financiare të projekteve, mund të ndikojë që ministria të mos i arrin synimet e caktuara dhe objektivat.
- Rekomandimi 13** Ministri duhet të sigurojë që komisionet vlerësuese bëjnë vlerësime objektive të projekteve, dhe se asnjë subjekt nuk do të subvencionohet nëse nuk i plotëson kërkesat e parapara me konkurse dhe me rregulloret përkatëse të subvencioneve.

#### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 634,597€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 545,673€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve për raste sociale.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.2 Pasuritë

#### 3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurisë kapitale në regjistrin kontabël, në fund të vitit 2016 ishte 18,515,042€, ndërsa vlera neto e pasurive jo kapitale ishte 86,701€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Bazuar në këtë kemi identifikuar mangësitë si në vijim.

<sup>2</sup> Hendikos Pejë 13,500€; Shpresa dhe shtëpitë e fëmijëve me vlerë 23,500€ dhe Këshilli Rinor i Rahovecit me vlerë 8,320€.

## Çështja 14 - Dobësi në menaxhimin e pasurive - Prioritet i lartë

**E gjetura** Auditimi ynë ka identifikuar disa mospajtueshmëri lidhur me përdorimin e pasurive të Ministrisë si në vijim:

- Për inventarizimin e pasurive ishte formuar një komision në nivel të organizatës, dhe komisione të veçanta për inventarizimin e pasurive në qendrat regjionale. Ne kemi vërejtur se inventarizimi ishte kryer sipas Rregullores MF-nr.02/2013 vetëm në nivel të zyrave regjionale, derisa inventarizimi në nivel qendror nuk ishte bërë sipas rregullores, ngase ishin identifikuar vetëm pasuritë jashtë përdorimit. Po ashtu raporti i inventarizimit, nuk ishte gjithëpërfshirës pasi nuk përmbante informatat për të gjitha pasuritë e ministrisë. Ky raport nuk ishte harmonizuar/krahasuar me regjistrat e pasurisë; dhe
- Ministria kishte lidhur marrëveshje mirëkuptimi me komuna të ndryshme për ndërtimin e objekteve për banim social. Sipas marrëveshjeve të mirëkuptimit, pronësia e objekteve pas përfundimit, do të kaloj tek komunat përkatëse. Për objektet e ndërtuara në Leposaviq dhe Zubin Potok, në vlerë të përbashkët prej 498,767€, nuk ishte nënshkruar pranimi i pasurisë nga zyrtarët përgjegjës të komunave.

**Rreziku** Mos azhurnimi i regjistrit të pasurisë, si dhe mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël, rrisin rrezikun që pasuritë të keqpërdorën, humben apo të tjetërsohen si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e drejtë. Derisa mos pranimi zyrtar i pronave nga institucionet përkatëse mund të rrezikoj që mos të identifikohet pronësia e tyre (të qëndrojnë ende pa pronësi).

**Rekomandimi 14** Ministri duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë e që menaxhimi dhe raportimi i tyre të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Me tutje duhet të sigurojë se procesi i bartjes së pronësisë së objekteve të ndërtuara të kompletohet me nënshkrimin e dokumentacionit nga të gjitha palët e përfshira në proces.

### 3.2.2 Te arkëtueshmet

Të hyrat e pa mbledhura dhe të prezantuara në PFV ishin 202,750€. Ato kanë të bëjnë me gjobat e shqiptuara nga inspektorati i punës.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

### 3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 628,374€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. MPMS nuk kishte kontrollë të mjaftueshme në menaxhimin e obligimeve të papaguara.

---

#### Çështja 15 - Raportim jo i plotë i obligimeve të papaguara - Prioritet i mesëm

- E gjetura** MPMS nuk ka aplikuar një proces të mirëfilltë të raportimit të faturave të papaguara, pasi ne kemi gjetur që obligimet në vlerë prej 50,740€, të paguara në vitin 2017, nuk ishin shpalos si obligime në PFV-të e vitit 2016.
- Rreziku** Mungesa e një procesi të mirëfilltë të mbledhjes dhe raportimit të obligimeve shpie në mos pagesë të tyre me kohë, mund të rezultojë me dëmtim të buxhetit si dhe mosarritje të objektivave për vitin e ardhshëm.
- Rekomandimi 15** Ministri duhet të sigurojë se është bërë një rishikim të procesit të raportimit të obligimeve, dhe të bëjë një vlerësim të menjëhershëm të obligimeve, për të marrë masa adekuate për përmirësimin e gjendjes aktuale.



---

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

---

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

---

## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.4 Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për ta siguruar vlerësimin dhe regjistrimin e plotë dhe të saktë të gjithë pasurive jokapitale dhe shpalosjen e drejtë të detyrimeve.			Nuk janë marrë masa
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është rishikuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Progresi i implementimit të rekomandimeve të AP duhet të monitorohet në baza të rregullta tremujore.	Po		
2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim i procesit për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Pyetëtori i vetvlerësimit ishte plotësuar por vëreheshin dallime të theksuara të notimit dhe dëshmime përkatëse. Poashtu lista e rreziqeve ishte bërë, por nuk janë monitoruar aktivitetet rreth menaxhimit të rreziqeve.	

2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies	Ministri duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe të raportimit ndaj departamenteve dhe qendrave rajonale, për të siguruar bashkëpunim dhe raportim më të efektshëm nga qendrat rajonale. Po ashtu duhet të rishikohet bashkëpunimi me ARC dhe ATK në mënyrë që vihet në pah përfitimi nga marrëveshjet e arritura. Kjo do të ndikoj në rregullsinë e pagesave për skemat pensionale dhe sociale dhe në kursimin e buxhetit.		Në proces – tani të gjitha departamentet raportojnë tek SP. Megjithatë disa nga raportet nuk përmbajnë informata të mjaftueshme. Edhe bashkëpunimi me ARC dhe ATK ka dhënë frytet e saj por listat nuk janë akoma të pastruara plotësisht.	
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim i formës aktuale të raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, dhe të sigurojë se raportimi i departamenteve të standardizohet dhe plotësohet me informatat e nevojshme, për të mbështetur një menaxhim më efektiv të veprimtarisë.		Në proces – shih komentin më lartë në lidhje me raportimet	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që të thellohet dialogu me Ministrinë e Financave rreth planifikimit të buxhetit me theks të veçantë tek skemat sociale dhe pensionale në mënyrë që të evitohen vështirësitë e vazhdueshme në realizimin e obligimeve ligjore dhe të synimeve paraprakisht të caktuara.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse në rastet e identifikuara kërkesat e prokurimit nuk janë respektuar në terësi si dhe të ndërmarr veprime për adresimin dhe parandalimin e tyre në të ardhmen.	Po		

3.4 Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë se do të merren masa për të siguruar se në të gjitha rastet kur kërkohet siguria e ekzekutimit, vlerat të jenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe kërkesat e dosjes së tenderit.	Po		
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri duhet të rishikoj kontrollet ekzistuese në lidhje me pagesat në avans dhe të vendos kontrolle për të siguruar mbylljen e tyre me kohë, të shoqëruara me dokumentacionin adekuat për të mbështetur validitetin.	Po		
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të shqyrtojë rastet e identifikuar dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimeve të aplikohen kërkesat e konkursit për të mundësuar punësimin a kandidatëve më meritore. Derisa kontratat e punës duhet ti përshtaten pozitive përkatëse.		Në proces- ende ka shumë angazhime përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, mirëpo po zbatohen procedurat e rekrutimit.	
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të sigurojë një plan më të qëndrueshëm dhe më mirë të menduar të rekrutimit para fillimit të procedurave për realizimin e tij për të evituar punësimet joadekuate dhe kostot financiare dhe administrative nga përsëritja e proceseve.	Po		
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të sigurojë se janë respektuar afatet ligjore në rastet e ushtrimit të pozitive të caktuara dhe që me kohë janë marrë masat e nevojshme për plotësimin e pozitive të lira.		Në proces të zbatimit - ishte zvogëluar numri i pozitive të mbajtura nga UD në krahasim më vitin e kaluar.	

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprimet e duhura në mënyrë që të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në pastrimin e listave, duke bërë krahasimin e vazhdueshëm sistematik të regjistrave me regjistrin civil, në baza mujore, para se të bëhet kompenzimi i pensioneve. Poashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për kthimin e pensioneve të dhëna pa bazë.		Kanë filluar harmonizimi i listave me agjencionet përkatëse (Agjencinë e Regjistrimit Civil, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Bashkësia Islame e Kosovës).	
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprimet e duhura për të siguruar forcimin e kontrolleve të brendshme në pastrimin e listave të pensioneve nga personat e punësuar, duke bërë krahasimet sistematike të shënimeve me ATK, para ekzekutimit të pagesave. Po ashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për kthimin e pensioneve të dhëna pa bazë.		Në proces - kanë filluar harmonizimet me listat e ATK së.	
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të sigurojë se do të vazhdoj forcimin e kontrolleve të brendshme duke krijuar sistem më efektiv të komunikimit të databazave ndërmjet skemave pensionale. Të shikohen mundësitë për krijim të një softueri të integruar të të gjitha skemave pensionale, në mënyrë që të eliminohet mundësia e përfitimeve të dyfishta të pensioneve. Poashtu duhet të merren të masat ligjore në mënyrë që përfituesit ti kthejnë mjetet e përfituara jashtëligjshëm në buxhetin e ministrisë.		Në proces - është zvogëluar dukshëm numri i përfituesve të dyfishta të pensioneve në shumicën e skemave (me përjashtim të veteranëve).	

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprime të nevojshme për qartësimin e bazës ligjore në mënyrë që të sigurohet se të gjithë veteranët do të trajtohen në mënyrë të barabartë. Në rast se me ligj apo marrëveshje me veteranët është vendosur që pensionet të paguhen në mënyrë retroaktive, atëherë duhet të bëhet pagesa për të gjithë ata që nuk i kanë marrë këto pensione. Në te kundërtën nëse ato pensione që janë paguar retroaktivisht nuk kanë qenë të rregullta, atëherë duhet të shqyrtohet mundësia që mjetet e paguara tepër t'u ndalen përfituesve në pagesat pasuese.			Nuk janë marrë masa
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të sigurojë që kompensimet për shërbimet e ofruara nga të angazhuarit në komisione do të bëhen nga kategoria e mallrave shërbimeve, në përputhje me kërkesat ligjore. Poashtu, duhet të sigurohet monitorim i mirëfilltë dhe arsyetim adekuat i mjeteve të marra në formë të subvencionit nga ana e përfituesve individual.		Në proces – pjesa e kompensimeve është zbatuar por kemi hasur në mos arsyetime të mjeteve nga OJQ-të.	
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Ministri duhet të sigurojë që në të ardhmen, komisioni i inventarizimit të formohet në nivel të organizatës, dhe të kryejë punën sipas kërkesave ligjore në mënyrë që vlera e pasurive në PVF të jetë e plotë dhe e saktë. Duhet të shtohen aktivitete për përfshirjen e të gjitha pasurive në regjistrat kontabël dhe në e-pasuria.		Në proces – komisioni kishte bërë inventarizimin nëpër qendrat regjionale mirëpo jo edhe në qendër (zyrët qendrore në Prishtinë). Komisioni kishte nxjerr një listë me inventarin jashtë funksionit.	



3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Ministri duhet të sigurojë që vendosen kontrole të shtuara në menaxhimin e automjeteve zyrtare, me theks të veçantë në arsyeshmërinë e shpenzimeve për veturat private. Duhet të aplikohen aprovimet paraprake për çdo tejkallim të nevojshëm të këtyre limiteve dhe të sigurohen raportime të rregullta të shpenzimeve për secilin automjet zyrtar.			Nuk janë marrë masa.
3.7.2 Trajtimi i borxheve	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të procesit të raportimit të obligimeve, për tu siguruar se do të bëhet vlerësim sistematik i borxheve dhe do të merren masat adekuate për përmirësim të gjendjes aktuale.			Nuk janë marrë masa.

## Shtojca IV: Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIE E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE Ministry of Labour and Social Welfare Министерство за Рад и Социјалну Заштиту			REPUBLIC OF KOSOVO NATIONAL AUDIT OFFICE NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE				
No. Prilid: 221 Dato: 13.06.2017	No. Prilid: 221 Dato: 13.06.2017		14.06.2017	<table border="1"> <tr> <td>21</td> <td>21-7</td> <td>658</td> <td>1</td> </tr> </table>	21	21-7	658
21	21-7	658	1				

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale / Ministarstvo za Rad i Socijalnu Zaštitu  
 Ministry of Labour and Social Welfare  
 Sekretari i Përgjithshëm / Generalni Sekretar / General Secretary

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Izedin Bytyqi  
 Sekretar i Përgjithshëm i MPMS

Data: 13 qershor 2017, Prishtinë